



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

1026

Nr. ___ Prot

Peshkopi, më __.03.2025

Lënda: Dërgojmë vendimin nr. 98 datë 10.03.2025.

Drejtuar: Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

Z. Ilirjan CELIBASHI

Rruga Ibrahim Rugova, nr.4 (pranë Katedrales Ortodokse), Tiranë.

I nderuar Z.Celibashi,

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, dekretit nr.399 të datës 05.12.2024 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë për “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kuvendin” me datë 11.05.2025, detyrimeve ligjore që na ngarkon pika 1 e nenit 79 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, udhëzimit nr.6 datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”, po ju dërgojmë vendimin nr. 98 datë 10.03.2025 “Për përcaktimin e vendeve publike në territorin e Bashkisë Dibër për afishimin e materialeve propagandistike nga subjektet zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin të datës 11 Maj 2025”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETARI I BASHKISË

RAHIM SPAHIU

NË MUNGESË DHE ME POROSI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KRYETARI

Nr. 98 Prot

Peshkopi, më 10.03.2025

VENDIM

Nr. 98 Datë 10.03.2025

**PËR PËRCAKTIMIN E VENDEVE PUBLIKE NË TERRITORIN E BASHKISË
DIBËR PËR AFISHIMIN E MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE NGA
SUBJEKTET ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN TË DATËS 11
MAJ 2025**

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, dekretit nr.399 të datës 05.12.2024 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë për “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kuvendin” me datë 11.05.2025, detyrimeve ligjore që na ngarkon pika 1 e nenit 79 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, udhëzimit nr.6 datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”.

V E N D O S A

Përcaktimin e vendeve publike në Bashkinë Dibër për afishimin e materialeve propagandistike nga subjektet zgjedhore gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin të datës 11.05.2025 si më poshtë vijon:

1. Njësia Administrative Peshkopi

- Segmenti rrugor ish NBSH deri ish SMT
- Bulevardi “ Elez Isufi”
- Lagjet “Dobrovë”, “Kamen”, “ Gjok Doçi” dhe “ Nazmi Rushiti”

1/1. Udhëzimi nr.6, datë 23.03.2021 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në nenin 3, pika 2 përcakton qartë se “Ndalohet afishimi i materialeve propagandistike në: fasadat e godinave të banimit, institucioneve publike apo ambienteve rrethuese pranë e pranë tyre, brenda zonave rekreative, parqeve, në pemët e qytetit dhe shtyllat e ndriçimit”, si dhe pika 3 “Ndalohet vendosja e materialeve propagandistike në mjete që operojnë në transportin publik”.

2. Në njësitë e tjera, përkatësisht në Maqellarë, Melan, Tomin, Kastriot, Fushë Çidhën, Arras, Muhurr, Luzni, Sllovë, Kala e Dodës, Zall Dardhë, Zall Reç, Selishtë, Lurë, afishimi i materialeve propagandistike për fushatën e zgjedhjeve të datës 11 Maj 2025 do të lejohet vetëm në qendrat e njësive administrative meqenëse aksesit publik është më i lartë, në mënyrë proporcionale ndërmjet subjekteve zgjedhore.
3. Nga sa më lartë dhe sipas përcaktimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 79 të Kodit Zgjedhor, ku specifikohet se *“Gjatë fushatës zgjedhore përdorimi dhe afishimi i çdo materiali tjetër statik për propagandë zgjedhore, përfshirë flamujt dhe posterat, lejohet vetëm në një largësi prej deri 5 metrash nga zyra zgjedhore e partisë politike apo subjektit zgjedhor përkatës”,* si dhe *“të gjitha materialet propagandistike vizive që përdoren në fushatë duhet të shoqërohen me shënimin “ Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore...”* (vijon emri i subjektit zgjedhor ose kandidatit).
4. Çdo afishim në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, si dhe në kundërshtim me këtë vendim, është i ndaluar. Në të kundërt Policia Bashkiake në bashkëpunim me Policinë e Shtetit do të garantojnë zbatimin e detyrimeve ligjore nga neni 79, duke hequr menjëherë materialet propagandistike jashtë përcaktimeve në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Subjektet Zgjedhore dhe Policia Bashkiake!
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë!

KRYETARI I BASHKISË
RAHIM SPAHIU

